

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-23-0037*****Në ankesën e******Paditësi/Ankuesi*****B L**, fshati B, Komuna Prishtinë, i përfaqësuar nga avokati, **S K**, Prishtinë.***Kundër******E paditura*****NSH, K.B "Bujqësia"**, Prishtinë (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Agron Hoxhaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2838 të datës 16 dhjetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 janar 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit e dates 25 janar 2023 e paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2838 të datës 16 dhjetor 2022, konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Asnjëra pale nuk ka të drejtë në rimbursimin e shpenzimeve procedurale.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 05 nëntor 2013, paditësi përmes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN009-0065 të datës 23 gusht 2013, me të cilën kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.03.2007 deri 31.01.2008, në shumën prej 2,145.00 euro refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi në ankesë këtë vendim e konsideron si të kundërligjshëm, pasi që ai pohon se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike dhe gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale. Tutje në ankesë ai pohon se kishte punuar në NSH deri me datë 31 janar 2008, dhe se ka të drejtë në paga të papaguara. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN009-0065 të datës 23 gusht 2013.

Me datë 04 shtator 2014, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja po ashtu pohon se kërkesa e paditësit për këto paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të paraqesë në ankesën e tij se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 03 tetor 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtjen në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi e kundërshton qëndrimin e AKP-së se kërkesa për paga është parashkruar. Tutje ai në këtë parashtresë i përsëritë pretendimet e veta të cekura në ankesë, duke pohuar se ai ka të drejtë në pagat e papaguara. Me këtë parashtresë ai dorëzon Autorizimin e Avokatit.

Me datë 06 nëntor 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i përsëritë pretendimet e veta të cekura në mbrojtje në ankesë.

Me datë 16 dhjetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-2838, ankesën e paditësit e refuzon si të pabazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi në bazë të nenit 42.2 të LDHP-së, dhe nenit 7 të LPK-së e kishte barrën e të provuarit, lidhur me pretendimet e tij për paga, ai ka dështuar të sjellë dëshmi në gjykatë për ekzistencën e marrëdhënies së punës me NSH-në, dëshmi për përvojën e punës, apo çfarëdo dokumenti apo Liste të pagave të punëtorëve që do të mund të dëshmonte kohën e saktë të punësimit, dhe deri kur ka qenë punëtor i NSH-së. Dëshmia e vetme që ka sjellë paditësi është Vendimi i kundërshtuar i Autoritetit të Likuidimit. Tutje shkalla e I-rë konstaton se paditësi me ankesë ka caktuar periudhën kohore të pagave dhe shumën që e kërkon, po e kërkon mirëpo nuk ka ofruar asnjë provë në mbështetje të ankesës.

Me datë 27 janar 2023, paditësi përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-13-2838, të datës 16 dhjetor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, aprovohet padia e paditësit si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182, paragrafi 2 pika n) të LPK-së, pasi që është dashtë që të hapë një seancë në mënyrë që të vërtetohet drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendja faktike. Tutje ai pohon se deri në kohën e privatizimit të NSH-së, ishte punëtor i saj, dhe atij nuk i janë paguar pagat nga NSH-ja. Tutje ai pohon se duke mos i dhënë mundësi palëve që në një seancë të paraqesin fakte dhe prova, kjo ka ndikuar që të mos vërtetohet drejtë gjendja faktike. Paditësi pohon se gjykata nuk ka marrë provat me të cilat dëshmohet se në vazhdimësi ka qenë punëtor i ndërmarrjes deri në kohën e privatizimit, me çka ka bazë të mjaftueshme që ai të përfshihet në listën e punëtorëve me të drejtë legjitime sipas legjislacionit në fuqi. Paditësi e konsideron si të pa drejtë dhe të kundërligjshëm Aktgjykimin e ankimuar, pasi që në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, e ndryshuar ,

punonjësit mund të marrin 20% të aksioneve nëse ata janë të regjistruar si punëtor të NSH-së, në kohën e privatizimit të saj. Tutje paditësi pohon se gjykata duke mos vërtetuar drejtë gjendjen faktike, gabimisht ka aplikuar edhe dispozitat materiale.

Më 01 shkurt 2023, Zyrtari për financa i DHPGJS-së ka nxjerr Vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për ankesë në shumën prej 20 Eurove, brenda 15 ditësh. Me anë të këtij njoftimi, ankuesi është paralajmëruar se nëse nuk e paguan taksën brenda afatit ligjorë prej 15 ditësh, ankesa e tij sipas nenit 253.4 dhe 253.5 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), nenit 6.4, 6.5 dhe 10.40 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikim të tarifave të gjykatës, do të konsiderohet e tërhequr. Ankuesi po ashtu është njoftuar se mund të parashtron kërkesën për lirim nga taksat gjyqësore në rast të mungesës së mjeteve financiare.

Vërejtja është dorëzuar tek përfaqësuesi i ankuesit më 06 shkurt 2023. Ankuesi deri më sot nuk e ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ka parashtruar kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Sipas nenit 253.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK): "Paditësi ka për detyrë që padisë t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar".

Më tutje, neni 253.5 thotë që: "Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, dhe

nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”.

Në bazë të nenit 3.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 (UA) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), përcaktimi i taksës gjyqësore për t'u paguar në kohën kur është paraqitur/parashtruar parashtresa, është i bazuar në vlerën e kontestit, respektivisht në natyrën e parashtresës.

Neni 2.4 i UA-së e përcakton se shprehja “Parashtresë”, do të thotë padi, kundërpadi, ankesë, kundërshtim, kërkesë, revizion, propozim për ekzekutim.

Udhëzimi i KGJK-së nr. 01/2017 i aplikueshëm që nga data 15/03/2017 për unifikimin e Taksave Gjyqësore të DHPGJS-së përcakton se ankuesi duhet të paguaj shumën fikse prej 20 euro për parashtrimin e ankesës.

Pasi që ankuesi nuk e ka paguar taksën gjyqësore siç është kërkuar nga ai me njoftimin (vërejtja) e datës 01 shkurt 2023, që ishte pranuar nga përfaqësuesi i ankuesit më 06 shkurt 2023, dhe nuk ka paraqitur kërkesë për lirim nga taksat gjyqësore, Kolegji i Apelit konsideron se ankesa është tërhequr.

Sipas nenit 11 të Ligjit për DHPGJS-në, pala e pasuksesshme duhet t'i paguaj shpenzimet procedurale, përfshirë taksat gjyqësore të palës tjetër. Ankuesja në këtë çështje është palë e pasuksesshme, prandaj shpenzimet gjyqësore janë në barrë e saj.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendosë si në dispozitiv.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
